



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1728 Prot.

Tiranë, më datë 20.12.2021

VENDIM
Nr. 692, datë 20.12.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 20.12.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e variantit të dyte të projektit të paraqitur “Ndërtimi i godinës, Godina Nr.22, blv. Zogu I (7-katëshi)”, monument kulture i kategorisë së II-të, me aplikues “Taulant” sh.p.k., projektues të licencuar në ndërhyrje në pasuri kulturore “Fusha” sh.p.k. dhe zhvillues Bashkia Tiranë, me kushtin që projekti arkitektonik:
 - për volumnin 7k duhet të ruhet pamja arkitektonike kryesore ekzistuese në dimensione, proporcione, materiale dhe të gjithë elementët arkitektonikë të përdorur;
 - 2 katet mbi volumnin 7k të respektojnë të njëjtën lartësi kati me atë të katit tip në volumnin 7k;
 - të eliminohen strukturat që mbulojnë tarracën përtej volumnit 2 kt;
 - të plotësohet me një relacion teknik të detajuar mbi metodologjinë e çmontimit të tesarave të fasadës kryerore, pastrimin, depozitimin dhe rivendosjen e tyre në vepër.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Subjekti duhet të dorëzojë 2 (dy) kopje fizike të nënshkuara elektronikisht të dokumentacionit tekniko-ligjor pranë Sekretarisë Teknike në IKTK;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;

6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO



KRYETAR

ELVA MARGARITI

